




KRM "ÇABRATI"

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Për menaxhimin e mbeturinave komunale

E lidhur me datë: 23.12.2020 ndërmjet palëve:

1. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i kësaj Komune z. Ardian Gjini, në tekstin vijues theksohet: Komuna.
2. Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "ÇABRATI", të cilën e përfaqëson z. Behar Ferizi Kryeshef Ekzekutiv i KRM "ÇABRATI", në tekstin vijues theksohet: "ÇABRATI".

Neni 1 Baza ligjore

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, nenit 9 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L -042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, arrihet Memorandumi i Mirëkuptimit me Kompaninë Regjionale të Mbeturinave KRM "ÇABRATI" për **menaxhimin e mbeturinave komunale**.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është që të ofrohet mbështetja Kompanisë Regjionale të Mbeturinave KRM "ÇABRATI" për menaxhimin e mbeturinave komunale në përputhje të nenit 1 të këtij memorandumi.

Neni 3

Roli dhe përgjegjësitë e komunës në menaxhimin e mbeturinave

Komuna ka përgjegjësi:

- a)** të krijoj sistemin për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave, sipas nenit 10 të Ligjit për Mbeturina dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij;
- b)** të zbatoj planet komunale;
- c)** të hartoj raportin vjetor për menaxhimin e mbeturinave, Raporti vjetor të cilin e dorëzon në Ministri deri më 31 mars të vitit vijues;
- d)** duke zbatuar procedurat e prokurimit, përzgjedh personat e licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre;
- e)** të caktoj tarifat dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale.
- f)** të ushtroj mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis.

Neni 4

Përgjegjësitë e palëve

4.1. Komuna është përgjegjëse për:

- a)** ofrimin e ndihmës dhe bashkëpunimit me Kompaninë Regjionale të Mbeturinave KRM “ÇABRATI” në mbledhjen, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
- b)** të ndihmoj KRM “ÇABRATI” në përcaktimin e tarifave dhe/ose mënyrën e inkasimit për sa i përket menaxhimit të mbeturinave.
- c)** ofrimin e ndihmës dhe bashkëpunimit kurdo që kërkohet nga KRM “ÇABRATI” në realizimin e shërbimeve të qëndrueshme në përputhje me Ligjin për Mbeturina.
- d)** të bëj raportin vjetor në MEA/AMMK, siç përcaktohet në Ligjin për Mbeturina

4.2. Kompania KRM “ÇABRATI” është përgjegjëse për:

- a)** nxjerrjen e planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave në përputhje me Ligjin për Mbeturina;
- b)** ofrimin e shërbimeve të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale në përputhje me Ligjin për Mbeturina;
- c)** përgatitjen e raporteve mbi menaxhimin e mbeturinave, si dhe ofrimin e mbështetjes së komunës për definimin e mënyrës së inkasimit dhe rritjes së mbulueshmërisë në ofrimin e shërbimeve në përputhje me Ligjin për Mbeturina

d) Menaxhimin e mbeturinave në përputhje me ligjin për Mbeturina

e) Raportim në baza mujore (Drejtoria për Shërbime Publike – Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit) për menaxhimin e mbeturinave, në mbështetjen e komunës për definimin e mënyrës së inkasimit dhe rritjes së mbulueshmërisë në ofrimin e shërbimeve në përputhje me Ligjin për Mbeturina

Neni 5

Kohëzgjatja e Memorandumit

Ky Memorandum fillon së zbatuari nga dt. 24.12.2020 dhe është e vlefshme për një periudhë kohore një (1) vjeçare, deri me 24.12.2021 me mundësi vazhdimi, përveç rastit kur është fjala për zgjidhje të parakohshme të këtij memorandumi të lidhur në mes palëve kontraktuese.

Neni 6

Monitorimi i memorandumit

Komuna për monitorimin e këtij memorandumi autorizon:

- Drejtorinë e Shërbimeve Publike – Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit
- Drejtorinë për Punë Inspektuese – Inspektori i Mjedisit

Neni 7

Zgjidhja e Mosmarrëveshjes

7.1 Në rast të çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me mos përmbushjen e obligimeve që i kanë palët në këtë memorandum, palët negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të konsensusit, kontestin në mes të palëve do ta zgjidh Gjykata Themelore në Gjakovë.

Neni 8

7.2 Ky memorandum është përpiluar në tre (3) kopje, prej të cilave nga një (1) kopje i dorëzohet palës kontraktuese.

P A L Ë T

Kryetari i Komunës së Gjakovës



Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Çabratë"

